REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKATHE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-400-54270
Me datë 29.10.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, e konform vendimit me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, të miratuar në Kuvendin e Komunës në Suharekë, e në mbështetje te nenit 44, lidhur me nenin 48, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

I. Lejohen mjete financiare në vlerë prej **3.000,00€** në emër të z. Gani BERISHA nga Suhareka, pasi që është shpallur nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, fitues i çmimit "Ukë Bytyçi" për Udhëheqje të mirë, mjetet lëshohen nga subvencionet e zyrës për bujqësi dhe zhvillim rural.

II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

III. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës në Suharekë me vendimin numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, ka themeluar çmimin "Ukë Bytyçi" për udhëheqje të mirë, më të cilin vendim është caktuar se aji i cili e fiton këtë çmim, vlera e çmimit është 3.000,00€, me vendimin e datës 23.10.2026 me numër të protokollit, 01-Nr-016-53005, të miratuar në Kuvendin e Komunës në Suharekës, z. Gani BERISHA, është shpallur fitues i çmimit "Ukë Bytyçi" për Udhëheqje të mirë, andaj duke ju referuar vendimeve të cekura më lartë, Kryetari i Komunës vendosi që mjetet financiare në vlerë prej **3.000,00€** të lëshohen në emër të z. Gani BERISHA pasi që është fitues i çmimit të lartë cekur, mjetet lëshohen nga subvencionet e zyrës së bujqësisë dhe zhvillim rural., andaj edhe u vendos si në nenin 1 të këtij aktvendimi

Me sa u tha më lartë vendos si në nenin 1 të këtij aktvendimi.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;
DEFB-ja
Pala
Evidenca